



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:290715

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05751058

P.nr.145/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Ali Kryeziu, në lëndën penale kundër të pandehurit **B.R.**nga, për shkak të veprës penale: në vazhdim vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzave të PTH-ës, në Gjilan, PP.II.nr.1921/2023 dhe 1926/2023 të datës 20.12.2023, duke vendosur sipas kërkesave të PTH-së në Gjilan, për dhënien e Urdhrave ndëshkimor, më datë 29.05.2024, hartoi dhe publikoi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesat e PTH-ës nga Gjilani PP.II.nr.1921/2023 dhe 1926/2023 të datës 20.12.2023, për dhënien e Urdhrave ndëshkimor ndaj të pandehurit,

B. R., nga babai M., i lindur me datë, me vendbanim në, ku edhe jeton, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r

S e p s e :

I.

Më datë 17.08.2023, rreth orës 14:30, minuta në territorin e në vendin e quajtur „.....”, në pyllin e pronës shtetërore, i pandehuri B. R., me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 165 – copë trungje të llojit „ Bung “ me diametër në cung 12-18 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.37 m3 i cili drunjët i kishte transportuar me veturën e markës „.....” në këtë

mënyrë të dëmtuarës APK – së zyra në Kamenicë i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

II.

Me datë 18.08.2023, rreth orës 15:30, në terrenin e fshatit Shipashnicë, komuna e Kamenicës, në vendin e quajtur „....., në pyllin e pronës shtetërore, i pandehuri B. R., me qëllim vjedhje, ka prerë 176-copa trungje të llojit „Bung”, me diametër në cung 10-16-cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.43m³, i cili drunjtë i kishte transportuar me veturën e markës „.....”, në këtë mënyrë, të dëmtuarës APK-së, zyra në Kamenicë, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale - në vazhdim vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-ës, si dhe nenit 364 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurin B. R. e,

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilën gjobë i pandehuri ka për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, nëse i pandehuri nuk e arkëton dënimin me gjobë në afatin prej 15 ditëve, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që çdo ditë burgu do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

E dëmtuara APK –ja në Kamenicë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor ta arkëtoj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjithashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të përgjithshme, më datën 20.12.2023, ka ngritur aktakuzat PP.II.nr.1921/2023 dhe PP.II.1926/2023, kundër të pandehurit B. R., nga, për shkak të veprave penale: vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, të KPRK-së, ndaj të cilit ka paraqitur edhe kërkesat për dhënien e Urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit të i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 493 parag. 2, lidhur me parag.1, dhe nenin 31 të KPPRK-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi aktakuzat, Kërkesat për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndëve dhe konstatoi se duhet të pranohen kërkesat e PTH-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë. Andaj gjykata duke pasur parasysh se ndaj të pandehurit në zhvillim e sipër ishte duke u zhvilluar procedura penale për dy lëndë, në të cilat lëndë kryesi i veprave penale ishte i njëjtë, pala e dëmtuar i njëjtë, veprat penale ishin të natyrës së njëjtë, e për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, në kuptim të nenit 34, paragrafi 1 dhe 7 të KPPRK-së, me Aktvendim, bëri bashkimin e lëndëve penale P.nr.145/2023 dhe P.nr.147/2023, në mënyrë që në të ardhmen, për të njëjtat çështje penale të zhvillohet një procedurë penale dhe të vendoset me një aktgjykim, ndërsa numri i përbashkët për këto dy lëndë do të mbetet ai më i vjetri, përkatësisht **P.nr.145/2023**. Po ashtu gjykata duke pasur parasysh faktin se për këto lëndë, objekti i veprave penale ishte i njëjtë, pala e dëmtuar e njëjtë, dashja e njëjtë e kryesit të veprave penale, e po ashtu duke pasur parasysh edhe afatin kohor të afërt të kryerjes së këtyre veprave penale, sipas detyrës zyrtare e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 359, paragrafi 2 të KPPRK-së, bëri rikualifikimin veprave penale nga vepra penale, vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, në veprën penale, *në vazhdim* vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në aktet akuzuese, edhe ato sa i përket veprës penale sipas pikës I. të aktakuzës, siç janë: Kallëzimi penal me nr. 321/2023 i dt. 15.12.2023, fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e dt. 07.09.2023, vlerësimi dhe llogaritja e dëmit në pyll i datës 07.09.2023, ndërsa sa i përket veprës penale si në pikën II. të dispozitivit të aktakuzës, si: Kallëzimi penal me nr. 316/2023 i dt. 14.12.2023, fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e dt. 07.09.2023, raporti i vlerësimit të dëmit nga komisioni i datës 07.09.2023, si dhe shkresat tjera të lëndëve, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me

bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikojë tek i pandehuri dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, prandaj e aprovoi kërkesat e PTH-së nga Gjilani, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të pandehurit i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë.

E dëmtuara APK –ja në Kamenicë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, e në pajtim me dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 449, paragrafi 2, pika 2.6 e KPPRK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), si dhe shumën prej 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat e më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:290715, 29.05.2024

G j y q t a r i ,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhrin ndëshkimor mundë të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i paraqitet kësaj gjykate, e pastaj gjykata do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor në pajtim me nenin 496 parag. 4 i KPPRK-së.